



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIË**

Nr. 2636/1 prot.

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1343, datë 11.05.2009.

SHOQËRISË “SANTARA” SH.P.K
Rruga “Kajo Karafili”, Seksioni 9 Katësh, Kati III, Apartamenti 34,
Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Santara” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1343, datë 11.05.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Kodër Krastë”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1668/1 datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2603 date 28.02.2019 dhe me shkresën nr. 1824, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.2636 date 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të nr.1343, datë 11.05.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Kodër Krastë”, Krujë, për arsye se:

- Nuk është zhvilluar aktivitet minerar në zonën, për të cilën është dhënë leja minerare për këtë objekt, pasi ka ushtruar aktivitet jashtë konturëve, të zonës së lejuar.
- Nuk ka realizuar shfrytëzimin në përputhje me projektin e miratuar, pasi në pjesën perëndimore lartësia e shkallës është 32m nga 10 – 12m që duhet të ishte dhe pjerrësia e madhe.

Afatit i vlefshmërisë se lejes minerare nr.1343 është data 11.05.2019, por afati nuk mund të zgjatet sepse zona ku ndodhet leja ka ndryshuar status, është shpallur peizazh i mbrojtur me VKM nr. 468 datë 26.07.2018 edhe pse shoqëria, në zbatim të pikës 6, të nenit 24, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka aplikuar për zgjatjen e afatit 180 ditë para përfundimit të afatit, për të cilin ishte dhënë leja.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germenin “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore

për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1343, datë 11.05.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Kodër Krastë ", Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1343, datë 11.05.2009, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Kodër Krastë ", Krujë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

